



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 08.10.2024

Nr: 184

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË FIER, ME KANDIDATIN
NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALDEMOKRATE”, Z. YMER
RIZA GOGA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 8452 prot., datë 20.08.2024, Këshilli i Bashkisë Fier, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, z. Erald Hasan Majushi, propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”.

Në mbështetje të nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, për Këshillin e Bashkisë Fier, të cilit i kalon mandati i Këshilltarit, është kandidati me numër rendor 7, z. Ymer Riza Goga.

Me shkresën nr. 2579, prot., datë 4.9.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Fier, z. Ymer Riza Goga., me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 08.10.2024 Nr:184
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, z. Ymer Riza Goga”.

pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e Këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për Këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit “Partia Socialdemokrate” ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër FR-PSD-4997_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të z. Ymer Riza Goga, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “Të dhëna mbi Gjendjen Gjyqësore të Personit”, të Formularit të Vetëdeklarimit, pyetjes 1: “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?
Subjekti vetëdeklarues është përgjigjur “Po” duke deklaruar se: “Është dënuar nga Gjykata Fier në vitin 1982, për një zënke, për të cilën citon se nuk ka bërë burg”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016 me shkresën nr. 2639 prot., datë 10.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 2637 prot., datë 10.9.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për z. Ymer Riza Goga.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 10045/1 prot., datë 19.9.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Ymer Riza Goga ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për z. Ymer Riza Goga, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar z. Ymer Riza Goga, në Këshillin e Bashkisë Fier, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e Këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Fier, me kandidatin nga lista shumemërore e “Partisë Socialdemokrate”, z. Ymer Riza Goga.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Iirjan CELIBASHI